



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE INFORMACIONIT

Nr. 1141 Prot.

Himarë, më 19 / 04 /2019

SHPALLJE VETËM PËR NËPUNËS CIVIL, NË KATEGORINË E LARTË DREJTUESE

Sekretar i Përgjithshëm, Bashkia Himarë – Kategoria e pagës I-b

Në zbatim të nenit 32, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut VIII, të Vendimit Nr. 118, datë 05/03/2014, **Bashkia Himarë** shpall procedurën e pranimit për pozicionin:

I. Sekretar i Përgjithshëm – Kategoria e pagës I-b

Afati për dorëzimin e dokumentave: 20.05.2019

- Ka rol kryesor lidhur me hartimin e politikave, objektivave dhe përparësitë e njësisë së qeverisjes vendore, si dhe për sigurimin e mbarëvajtjes së aktivitetit të Bashkisë në përputhje me ligjet, aktet nënligjore apo aktet rregullatore në fuqi me qëllim përmbushjen e misionit të Bashkisë.
- Siguron që burimet materiale, financiare dhe njerëzore, në dispozicion të Bashkisë, organizohen dhe përdoren në mënyrë të tillë që objektivat dhe misioni i qeverisjes vendore të realizohen në mënyrë eficiente dhe efektive duke respektuar të gjithë kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Siguron zgjidhjen e problemeve të ndryshme dhe komplekse, me një vendimarrje strategjike, konstante, komplekse në përputhje me kuadrin ligjor.
- Menaxhon nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë të Institucionit, organizon punën dhe përcakton detyrat sipas Njësive Administrative.

1.1 KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në nivelin e mesëm drejtues, në shërbimin civil.
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit "mirë" apo "shumë mirë".

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në shkencën Juridike, edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë. Përparësi përbën kryerja e studimeve dhe kualifikimeve pasuniversitare në fushën përkatëse. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b- Të kenë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura.
- c- Të kenë eksperiencë si nëpunës civil në nivelin e mesëm drejtues jo më pak se 3 vite.
- d- Të zotërojnë aftësi të mira komunikimi, drejtimi, bashkëpunimi për ndërtimin e marrëdhënieve ndërpersonale, efektiviteti, për të punuar në grup, për të kuptuar me gjërë kompetencat ndërsektoriale, të ketë njohuri mbi fenomenet sociale dhe ekonomike, të krijojë besueshmëri, integritet, të jetë krijues, si dhe të ketë njohuri për sistemin ligjor Evropian.
- e- Të kenë kualifikime të ndryshme brenda fushës së punës.
- f- Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Himarë, brenda dates 20.05.2019.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **30.05.2019**, Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit e Bashkisë Himarë, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Faqen Zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit e Bashkisë Himarë, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij.
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave".
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".
- f) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit".
- g) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave".
- h) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (I ndryshuar).
- i) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 138/2015, datë 17.12.2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur", të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al). <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Himarë do të shpallë fituesin në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit". Faqen Zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën

Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit

BASHKIA HIMARË

